



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 335/14 prot.

Datë 24.03.2026

**V E N D I M**

**Nr. 418/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.332/2026, datë 03.03.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-68215-11-10-2025, me objekt " ZBATIMI I PLANIT PILOT: BLERJA DHE INSTALIMI I PANELEVE DIELLORE”. (Kontratë me Celësa në dorë), me fond limit 17.777.820 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 22.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “HTM” Shpk me NIPT K97006004D dhe adresë: Lagja Perash, Rruga Rrojej, Nr 44, Shkodër.
- Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Portual Durrës me adresë: Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës.
- Subjekte të interesuara:** OE “LAVIVA TECHNOLOGIES” Shpk me NUIS M01323012A me adresa: Rruga : "At Zef Valentini", Kompleks Magazina, Kati 1, Njësia Bashkiake 11, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit

*Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 03.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.332/2026, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar, për operatorin ekonomik “HTM” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-68215-11-10-2025, me objekt " ZBATIMI I PLANIT PILOT: BLERJA DHE INSTALIMI I PANELEVE DIELORE". (Kontratë me Celësa në dorë), me fond limit 17.777.820 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 22.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës dhe Autoriteti Kontraktor të pasqyrojë zbatimin e vendimit sipas vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.*
- 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “HTM” SHPK, duke zbatuar Vendimin e KSHA-së me nr. 612 prot., datë 16.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 335/3 prot., datë 18.02.2026, me objekt “Kthim përgjigje ankesës online nr.aplikimi A2026/6302, datë 03.02.2026”.*
- 3. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “HTM” SHPK, për procedurën e prokurimit.*
- 4. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “HTM” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.*
- 5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “HTM” SHPK.*
- 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 8. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 835/1 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 335/11 prot., datë 19.03.2026, autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 332/2026, datë 03.03.2026.

### **II**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën përcjellëse me nr. 835/1 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 335/11 prot., datë 19.03.2026, autortiteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 332/2026, datë 03.03.2026.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 835/1 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 335/11 prot., datë 19.03.2026, nëpërmjet shërbimit postar, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.332/2026, datë 03.03.2026, duke rivlerësuar arsyet e skualifikimit për OE "HTM" SHPK dhe statusi i këtij OE qëndron përsëri "I skualifikuar".

Ndërsa për operatorin ekonomik "LAVIVA TECHNOLOGIES" Shpk, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.332/2026, datë 03.03.2026, duke rivlerësuar këtë subjekt ofertues dhe pas rivlerësimit statusi nga "I kualifikuar" është ndryshuar në statusin "I Skualifikuar", ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor në raportin e auditit, të gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik (SPE), duke zbatuar Vendimin e KSHA-së me nr. 612 prot., datë 16.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 335/3 prot., datë 18.02.2026, me objekt "Kthim përgjigje ankesës online nr.aplikimi A2026/6302, datë 03.02.2026".

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "E hapur - mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-68215-11-10-2025, me objekt " ZBATIMI I PLANIT PILOT: BLERJA DHE INSTALIMI I PANELEVE DIELORE". (Kontratë me Celësa në dorë), me fond limit 17.777.820 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 22.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar  
Anila Malaj

Anëtar  
Gjergj Mersini

Nënkryetar  
Fiorent Zguro

